



Datë: 14.05.2026

A.nr.334/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.334/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesja E.R, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontest nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.334/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesja E.R.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile E.R (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 24.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër formularit të datës 20.02.2026, lidhur më Vlerësimin e performances në punë për vitin 2025, ndërsa, e njëjta me datë 13.05.2026 (përmes e-mailit zyrtar) ka përcjell deklaratën për tërheqje nga ankesa të datës 24.03.2026, me arsyetimin se ka pranuar ri-vlerësimin nga mbikëqyrësi.

Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë kërkesën e datës 13.05.2026 të ankueses për tërheqje nga ankesa e datës 24.03.2026, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, dhe si rrjedhojë, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.334/2026, të datës 24.03.2026.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.334/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, E.R;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.